

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI JURIDIK**

**Kandidatja:** Arbenita Berisha

**Mentori:** Prof.Dr.Bedri Peci

**Tema:** “Transparenca e financimit të partive politike në Kosovë”

**Abstrakti**

Duke marrë parasysh se partitë politike si aktere të zhvillimeve shoqërore e politike kanë një ndikim të konsiderueshëm në përgjithësi, veqanërisht në vendet në konsolidim e sipër të demokracisë. Rrjedhimisht duke marrë për bazë këtë ndikim të madh të partive politike në jetën dhe zhvillimin e shoqërisë së Kosovës, është mjaft e arsyetuar kërkesa qytetare për të pasur transparencë dhe qasje të hapur ndaj mënyrës se si partitë politike funksionojnë, si i ndërtojnë agjendat e tyre dhe veqanërisht në kuadër të funksionimit të tyre si financohen ato. Për të funksionuar partitë politike siç edhe ekziston praktika e tillë pothuajse në çdo vend, kanë nevojë për mjete financiare në mënyrë që të realizojnë agjendat e tyre dhe të sigurojnë administrim të mirëfillt. Pjesa përmbajtësore që vendosë bazën e transparencës së financimit lidhte partitë politike me obligime ligjore jo vetëm për të deklaruar burimet e financimit por edhe për të ofruar dëshmi të prejardhjes së tyre, në të kundërtën, dorëzimin e mjeteve në buxhetin e Republikës së Kosovës. Pavarësisht nëse duket e drejtë për t’u cilësuar apo jo, teorikisht ekziston një bindje qytetare se partitë politike kanë financues të ndryshëm nga sfera private, që i ndërlidhin interesat e tyre ekonomike me ndikimin që kanë partitë politike, me theks të veçantë ato në pushtet. Megjithatë, baza e parë ligjore që e trajtoi çështjen e financimit të partive dhe bëri transparente të financuesve të tyre ishte një rregullore e UNMIKU-të e vitit 2004 e cila sanksiononte kushtet mbi të cilat një parti politike mund të pranojë donacione. Shtyllat bazë të kësaj rregulloreje ishin me theks të veçantë të vendosura në nenin 16, pika 16.2 e cila sanksiononte çdo pranim të mjeteve nga palë të paidentifikuara përmes emrit dhe numrit personal të identitetit, si dhe pika 16.3 e cila sanksiononte kontributet e dhëna në mënyrë të tërthortë përmes një personi nga paratë, pasuria apo shërbimet e palës së tretë, paraqesin dy shtylla bazë për sigurimin e transparencës së financimit.